

DOKUMENTI KONSULTATIV

Për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar”

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit në kuadër të procesit të konsultimit “Për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar” mirëpret sugjerimet nga qytetarët, ekspertë të fushës, nga të gjitha institucionet dhe subjektet e interesuara, organizata jofitimprurëse, shoqëria civile, të drejtat ose objekti i veprimtarisë të të cilave ka të bëjë apo ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga përcaktimet e kësaj nisme.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik: 20 ditë pune, duke filluar nga data 13.02.2026 13.03.2026.

Si të përgjigjeni:

Kontributet që në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, do të përcillen nga institucionet e interesuara me anë të regjistrimit elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

Kontakti:

Eliverta Vraniçi, Koordinator për konsultimin publik në Ministri:
Eliverta.Vranici@mtks.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” 20 ditë pune, duke filluar nga data 13.02.2026.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar” Ky ndryshim vjen në vijim të gjetjeve nga Raporti i SiGMA i kryer në vitin 2025, lidhur me “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”. Objekti kryesor i këtij raporti kishte të bënte me vlerësimin e situatës aktuale si dhe dhënien e rekomandimeve me fokus forcimin e qendrës së qeverisjes së Shqipërisë, duke integruar në mënyrë efektive parimet e Qeverisjes së Përbashkët në përputhje me parimet e Administratës Publike, veçanërisht ato që lidhen me koherencën e politikave, planifikimin strategjik, hartimin e politikave të bazuara në prova dhe konsultimin me palët e interesuara, duke mbështetur kështu vendin në rrugëtimin drejt anëtarësimit në BE, e njëkohësisht duke siguruar qeverisje më efektive, ofrim më të mirë të shërbimeve dhe zbatim të qëndrueshëm të politikave.

Në këto kushte, është rekomanduar një reduktim i numrit të institucioneve në varësi të Kryeministrit, duke bërë edhe sugjerimet konkrete për kalimin e varësisë së këtyre

institucioneve. Konkretisht për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave është sugjeruar të jetë institucion në varësi të ministrit përgjegjës për kulturën.

Propozimet

Ky projektligj ka si përparësi dhe efekte të pritshme: të ndryshojë varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, nga Kryeministria që është aktualisht, në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Ministria përgjegjëse për kulturën, referuar fushës së përgjegjësisë, si dhe duke pasur në konsideratë që Institucionet e Rrjetit Arkivor Kombëtar janë institucione të specializuara në kuptim të ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë Kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar, përbën autoritetin më të përshtatshëm për mbikëqyrjen dhe koordinimin e veprimtarisë së këtij institucioni.

Pyetjet

Reagimet që priten janë të hapura dhe nuk parashikohet ngritja e pyetjeve specifike, të cilat kërkojnë përgjigje. Pyetje të mundshme mund të jenë: A pajtoheni me qartësinë e informacionit të paraqitur në dokument dhe çfarë do të propozonit shtesë për të përmirësuar cilësinë e tij? Si i vlerësoni përcaktimet në këtë projektligj.